



KOMUNA E VUSHTRISË
DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

PROTOKOLL

**RREGULLAT PËR HAPJEN E SHKOLLAVE NË KOMUNËN E VUSHTRISË
PËR VITIN SHKOLLOR 2020-2021**

NË KUSHTE PANDEMIE COVID 19 (SARS-CoV-2)

Pas vendimit të fundit të Qeverisë të Republikës së Kosovës, që mësimi për vitin shkollor 2020 / 2021 të fillojë në shkolla, Komuna e Vushtrrisë, me synimin që të mbrojë shëndetin e nxënësve dhe punonjësve të shkollave, sipas përgjegjësisë që ka, cakton rregullat bazë të sjelljes për nxënës, mësimdhënës e punonjës tjerë në shkolla gjatë vitit shkollor 2020-2021, për kushte pandemie, në mënyrë që t'u lehtësohet puna institucioneve arsimore.

Në komunën e Vushtrrisë janë 35 shkolla publike, (fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta por që SHFMU Rrustem Hyseni në Skromë sipas të gjitha gjasave nuk do të punojë sepse nuk ka nxënës) dhe një institucion parashkollor e që synohet të funksionalizohet edhe një tjetër, të cilat menaxhohen nga DKA.

I. Përgatitja dhe mirëmbajtja e objektit shkollor

(Përgjegjësitë e shkollës)

- Dezinfektimi (materiale të sigurohen në koordinim me DKA);
- Pastrimi i tërë objektit të shkollës para 1 shtatorit (nga punëtorët teknikë);
- Vendoset tepihu me vëllim, me dezinfektues me bazë klori, në hyrje të shkollës (nga shkolla);
- Pastrimi bëhet me lëndë dezinfektuese dhe tregohet kujdes i veçantë në hapësirat më frekuentuese, si: klasat, tualetet, korridoret dhe hapësirat tjera të përbashkëta, sallat e edukatës fizike, bibliotekat e të ngjashme dhe kontrollon nga anëtarët e Task-Forcës. (Sipas Udhëzuesit nga MASH);
- Të gjitha shkollat duhet të pajisen me termometer laserik;
- Të planifikohet sistemimi i nxënësve në klasa, duhet pasur parasysh distancën e mjaftueshme, (sipas udhëzimeve të MASH dhe ISH)
- Sportet dhe aktivitetet e ndryshme fizike, rekomandohet të realizohen në ambientet e jashtme të shkollës;
- Të përgatiten instruksionet për hyrje në shkollë, në mënyrë që të parandalohet grumbullimi i nxënësve në oborr apo në objekt shkollor.
- Mësimdhënësit dhe stafi me simptoma të Covid – 19 por edhe me sëmundje/problem tjera rekomandohen të lajmërojnë shkollën para fillimit të vitit shkollor.

Gjatë udhëtimit për në institucionin arsimor dhe anasjelltas

Gjatë udhëtimit për në institucionin arsimor duhet respektuar rregullat e sjelljes, të specifikuar nga MASH dhe IKSHPK, të zbatohen në përpikëri;

- Vendosja e maskave duke mbuluar gojën dhe hundë;
- Mbajtja e distancës sipas rekomandimeve të IKSHPK;
- Ndalesa e transportit të bëhet në hapësirën ku nxënësit dhe stafi arsimor mund të hipin dhe zbresin duke respektuar distancën;
- Çdo nxënës, mësimdhënës e punonjës tjetër i shkollës duhet të respektojë me përpikëri orarin e caktuar nga shkolla, me qëllim të shmangies së grumbullimit të nxënësve në të njëjtën kohë.

II. Rregullat në oborrin e shkollës

- ✓ Të bëhet matja e temperaturës së nxënësve (në hyrje të objektit shkollor) dhe në rastet kur temperatura kalon mbi 37.5°, duhet të evidentohen dhe të kthehen në shtëpi (të lajmërohet prindi paraprakisht);
- ✓ Në çdo rast duhet të evitohen grumbullimet e nxënësve në oborr apo hyrje të shkollës;
- ✓ Të shënohet distanca me llak/spërkatës me ngjyrë (në dyshemenë e hyrjes së shkollës);
- ✓ Secili person që hyn në oborr/ institucion, duhet të vendosë maskë mbrojtëse.

III. Pranimi i nxënësve në shkollë

- Ju matet temperatura gjithë stafit para kontaktit me nxënësit;
- Nxënësit pranohen nga mësimdhënësi i lëndës, në hyrje të objektit, sipas orarit të paraparë nga menaxhmenti i shkollës;
- Hyrja e nxënësve në shkollë bëhet duke respektuar rregullat e IKSHPK-së;
- Mbajtja e distancës, shënimi (1.5m largësi) para hyrjes në objektin shkollor, dezinfektimi i duarve në hyrje të shkollës, mbajtja e maskave (mbulimi i gojës dhe hundës) gjatë gjithë kohës sa nxënësi të qëndrojë në shkollë;
- Mjetet e punës së nxënësve duhet të jenë individuale dhe të mos ndahen me të tjerët.

IV. Organizimi i procesit mësimor

Të hartohet orari mësimor, si vijon:

- Varësisht nga situatë epidemiologjike, të caktohet numri i nxënësve në klasa (më së shumti 20 nëse shkalla e rrezikut nuk vlerësohet e lartë) në rast se klasa ka numër më të madh të nxënësve, ndahet klasa në dy apo më shumë grupe;
- Fillimisht orët mësimore në klasa do të zgjasin nga 30 minuta, për klasat përgatitore 2 orë mësimore dhe klasat fillore më së shumti 3 orë mësimore, distanca kohore në mes dy ndërrimeve të jetë 30-40 minuta për shkollat me numër të vogël të nxënësve dhe 40-50 minuta për shkollat me numër të madh të nxënësve;
- Për klasat 6 – 9 vlejnjë të njejtat rregulla, me dallim që në shkollat ku numri i madh nxënësve kërkon të punohet në më shumë se 2 ndërrime do të aplikohet Skenari B (mësim i kombinuar) i MASH.
- Shkollat e Mesme të Larta - shkollat profesionale, bazuar në udhëzuesin MASH orarin e mësimimit për një ndërresë do ta kenë më së shumti 3 orë e 30 minuta, kohëzgjatja e orës 30 minuta maksimum dhe do të përfshijnë pothuaj të gjitha lëndët, do të kushtojnë rëndësi mësimimit praktik, me grupe më të vogla të nxënësve, kurse në gjimnaz për fillim do të punohet si me klasat 6-9 fillimisht nga 3 orë mësimi nga 30 minuta, përveq lëndëve gjuhë shqipe dhe matematikë duhet të planifikohen edhe lëndët prioritare varësisht nga drejtimi.

Shënim:

- Në shkollat ku numri i nxënësve është më i vogël se 16 nxënës në një klasë, mund ta zhvillojnë orarin e rregullt mësimor jo më shumë se 30 minuta një orë mësimore;
- Pushimet e ndryshme në mes të orëve mësimore, do të planifikohen/organizohen nga Task-Forca, në mënyrë që frekuentimi të jetë vetëm me distancën e rekomandueshme.

V. Si të vepohet në rastet potenciale me Covid - 19?

- Nëse ka ndonjë rast të dyshuar, apo edhe të konfirmuar me Covid - 19, qoftë nga radhët e nxënësve apo stafit të shkollës, atëherë duhet të dezinfektohet hapësira shkollore;

- Nëse rritet numri i të infektuarve nga radhët e stafit dhe nxënësve të prekur me Covid - 19, atëherë mbyllet shkolla;
- Nxënësit të cilët kanë familjarë që kanë rezultuar pozitiv me Covid – 19, nuk mund të pranohen në shkollë, sepse janë shpërndarësit potencialë, (mungesat në orët mësimore konsiderohen të arsyeshme);
- Mësimdhënësit, punonjësit e shkollës të cilët kanë familjar me Covid – 19, nuk vijojnë në punë, ata do të punojnë në distancë, derisa të rezultojnë negativ në test;
- Nëse paraqitet ndonjë rast i fëmijëve me Covid - 19 në shkollë, nuk është e domosdoshme që i tërë grupi të shkojë në vetizolim, por duhet të përcillet gjendja shëndetësore e nxënësve nga prindërit dhe nga mësimdhënësit, duke përfshirë matjen e temperaturës trupore në shtëpi dhe në shkollë;
- Nxënësit të cilët shfaqin simptoma eventuale brenda ditës, gjatë qëndrimit në shkollë duhet të vendosen në këndin e përcaktuar nga Task-Forca, derisa prindërit/kujdestarët ligjorë të marrin fëmijën nga shkolla;
- Nëse një mësimdhënës është izoluar për shkak të infektimit:
 - a) Ajo klasë që është në nivelin fillor, kalon automatikisht në skenarin “C” (mësimi në distancë);
 - b) Ndërkaq, nëse është mësimdhënës i nivelit të mesëm të ulët dhe të lartë, zgjidhjen e bën drejtori, në bashkëpunim me DKA-në.

VI. Obligimet e shkollës

- Të raportojë në DKA për çdo rast eventuale (të infektuar);
 - Të obligojë të gjithë mësimdhënësit, të krijojnë grupin virtual me prindër;
 - Të sigurojë që janë dukë u zbatuar në detaje udhëzuesit e MASH;
 - Të sigurojë zbatueshmërinë e protokollit në tërësi;
 - T’i referohet protokollit për masat lehtësuese për rifillimin e punës në institucionet parashkollore në Kosovë, të përpiluar nga MASH;
 - Të formojë Task-Forcën në nivel shkollë, të cilët duhet të takohen (fizikisht apo në mënyrë virtuale) çdo fundjavë, me këtë përbërje:
1. Kryetari i Këshillit Drejtues;
 2. Drejtori i shkollës,
 3. Kryetari i Këshillit të Klasave ose koordinatori i cilësisë, ose njëri nga anëtarët e KDSH-së nga radhët e mësimdhënësve;
 4. Kryetari i Këshillit të Prindërve;
 5. Përfaqësuesi për logjistikë – sekretari, administratori;
 6. Mësimdhënësi mbështetës për përdorimin e TIK.

VII. Obligimet dhe përgjegjësitë e mësimdhënësve

- Nga mësimdhënësi kujdestar, të njoftohen nxënësit dhe prindërit për grupin dhe kohën e vijimit të mësimin në shkollë;
- Mësimdhënësit/stafi i shkollës obligohen të bartin maska gjatë gjithë kohës;

- Mësimdhënësi kujdeset për ajrosjen e klasës dhe për mirëmbajtjen e klasës së vetë; Caktimi i vendit për secilin fëmijë/ nxënës dhe ndalimi rreptësisht i ndërrimit të vendeve;
- Mbledhjet me prindër mbahen sipas kushteve fizike ose virtuale; Në sallën e edukatës fizike, përgjegjës është mësimdhënësi i lëndës përkatëse, në mënyrë që të mos rrezikohet shëndeti i nxënësve (mbahet distancë). Mësimdhënësi kujdestar i ditës, pret nxënësit dhe bën matjen e temperaturës trupore përmes termometrit;
- Mësimdhënësit kujdestarë, duhet të mbajnë kontakte të vazhdueshme me prindërit e nxënësve të tyre.
- Numri i kujdestarëve të ditës nga radhët e mësimdhënësve në shkollë duhet të jetë më i madh (në shkollat me numër të madh të nxënësve 4-6 në ndërrim).
- Përveq këtyre obligimeve, vlejné të gjitha obligimet tjera ligjore në fuqi.

VIII. Detyrat dhe përgjegjësitë e prindërve

- Prindërit nuk mund të hyjnë (ndalohe) në objektin shkollor (për të ruajtur shëndetin e frekuentuesve brenda shkollës);
- Obligohen të bartin maskën gjatë gjithë kohës (edhe në hapësirat e jasht objektit shkollor);
- Janë të obliguar të sigurojnë maskën për fëmijët e tyre;
- Dërgimi i fëmijëve në shkollë, klasat 0, I, II, III, etj., bëhet nga i njëjti prind gjatë tërë kohës, dhe nuk rekomandohet që ky proces të kryhet nga gjyshërit apo personat mbi moshën 60 vjeç;
- Prindi mund të pranojë dhe të japë informatën përmes personit të autorizuar, përmes telefonit apo e-mail-it zyrtarë;
- Në rast se nxënësi ka simptoma, prindi obligohet që të marrë fëmijën e vet;
- Prindërit duhet t'i këshillojnë fëmijët e tyre për respektimin e rregullave dhe masave parandaluese ndaj Covid -19;
- Prindërit obligohen të njoftojnë shkollën nëse fëmija ose familjarët janë me simptoma apo të prekur me Covid -19.
- Përveq këtyre rregullave, vlejné të gjitha rregullat tjera ligjore në fuqi.

IX. Detyrat dhe përgjegjësitë e Task-Forcës së shkollës

- Të përpilojnë Planin e veprimit për obligimet, detyrat dhe përgjegjësitë (duke u bazuar në këtë plan të veprimit/protokoll, por vetëm specifikat e shkollës mund t'i shtojnë);
- Të kontrollojnë/ monitorojnë pastrimin dhe dezinfektimin e objektit në bazaditore e javore, për të mbështetur dhe për të parë se a janë duke u realizuar të gjitha obligimet dhe përgjegjësitë e planifikuara/ përcaktuara (listat e kontrollit /check-listat);
- Të shpërblejë me mirënjohje më të dalluarit dhe të sanksionojë me vërejtje për pakujdesi dhe neglizhencë në punë;
- Kontrollon hapësirat në klasa për distancën 1.5 metra, minimum.

Shënim: Ky Protokoll mund të ndryshohet varësisht nga funksionaliteti dhe vlerësimet e situatës epidemiologjike.

Hartues:

Task-Forca komunale Vushtrri